

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KEK-24-7308-1-3-6**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me zinxhirë lamellor**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	<b>UNION L.L.C</b>
NUI	<b>600506672</b>
Adresa	<b>Bulevardi Nena Tereze Nr.416</b>
Vendi	<b>Prishtine</b>
Kodi postar	<b>10000</b>
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	<b>SHEMSI BAJGORA</b>
Adresa elektronike	<b>union-llc@hotmail.com</b>
Data e parashtrimit të ankesës	<b>09.09.2024</b>

*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

#### 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit  
Adresa e plotë  
Numri i Telefonit  
Numri i faks-it  
Adresa elektronike

#### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

**Furnizim me zinxhirë lamellor**

**Data e njoftimit 17.07.2024**

**Afati për dorëzimin e ofertave/kërkesës për pjesëmarrje 25.07.2024**

**B58 Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues 26.08.2024**

**Qasja në dokumentacion 27.08.2024**

**Kërkesa për rishqyrtim 28.08.2024**

#### **4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet**

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po ☐

Jo ☒

#### **5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet**

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po ☒

Jo ☐

#### **6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po ☒

Jo ☐

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.*

**Kërkesa për rishqyrtim 28.08.2024**

#### **7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Dispozitat e LPP-së që jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues gjatë vlersimit të ofertave

jane ;LIGJI NR.04/L-042 (Versioni i Konsoliduar)

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 28 Specifikimet teknike

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Pershendetje,

Me datën 26.08.2024 kemi pranuar Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues - ku propozohet OE GETNO LLC të shpërblehet me kontratë për aktivitetin Numri i Prokurimit: KEKO-24-189-136– Titulli Furnizim me zinxhirë lamellor

Me datën 26.08.2024 kemi kërkuar që të na mundësohet qasja në dokumentacion.

Me datën 27.08.2024 na është mundësuar qasja në dokumentacion të OE GETNO LLC. OE GETNO LLC ka prezentuar Certifikatën ISO 9001 të kompanisë KTS Kettentechnik GmbH e cila është e certifikuar me ISO 9001 për shitje dhe jo për prodhim (fusha e miratimit -Shitje në teknologjinë e ngasjeve veqanërisht zinxhir rulor dhe dhembzor) shiko ISO9001 të prezentuar nga OE me rastin e ofertimit, gjë që është në kundërshtim me kërkesat në dosjen e tenderit pika III.4 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale.

Me të njëjten arsye jemi eliminuar në nga zyra e prokurimit për aktivitetin KEKO-24-021-121 me datën 08.03.2024 shiko të bashkangjitur. Besojmë që i njëjti vendim duhet të vlejë edhe në këtë rast.

Në qoftë se jo atëherë në këtë rast kemi favorizim të hapur dhe në do të detyrohemi të drejtohem OSHP.

Me datën 30.08.2024 na është kthyer kërkesa për rishqyrtim si e pa bazuar duke theksuar që kompania në fjalë është prodhuese.

Shumë kohë shihet në certifikatën ISO 9001 që kompania është e certifikuar për shitje dhe jo për prodhim. Pasi që kemi marrë refuzimin të të pa bazuar nga AK në kemi kontaktuar kompaninë KTS Kettentechnik GmbH ku edhe vetë ata përmes email na kanë konfirmuar me email që nuk e prodhojnë këtë lloj produkti. Në qoftë se është e nevojshme në mund ta përfaqësojmë edhe këtë fakt pranë panelit të OSHP.

Kerkojm qe lenda te kthehet ne rivlersim dhe te mirret vendim meritior.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**PREGATIDJA E OFERTES 300 EURO**

**PREGADITJA E ANKESES PRAN OSHP 200 EURO**

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*